



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 55/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____ pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, të përmbaruesit privat, z. _____ dhe palës ankuese z. _____ dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës ankuese Av. _____ dhe pas seancës këshillimore, me datën 08.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL. Nr 55/2021, dt 23.11.2021 si dhe ankesa e pala ankuese z. _____ dt 22.11.2021, si të pasafatshme.

A R S Y E T I M

Me datën 12.11.2021, përkatësisht me datën 22.11.2021, pala ankuese z. _____ nga _____ ka paraqitur një ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira, Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. _____. Pala ankuese pretendon se përmbaruesi privat z. _____ me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore ka kryer shkelje disiplinore duke tejkaluar autorizimet ligjore dhe ka vepruar në kundërshtim me ligjin me rastin e dorëzimit të urdhrit përmbarimor, ka keqpërdor me nënshkrimet në fletë dorëzimet e postës. Po ashtu, përmbaruesi privat pretendohet se ka kryer shkelje disiplinore duke mos treguar kujdesin e duhur dhe është pasuruar pa bazë, ka përfituar në mënyrë të paligjshme dhe, duke mos i dërguar shkresat e lëndës përmbarimore i njëjti ka bërë shkelje disiplinore. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat z. _____ në çdo formë, kishte

MINISTRIA E DREJTËSISË
DEPARTAMENTI PËR PROFESIONE TË LIRA
DIVIZIONI PËR NOTERINË DHE PËRMBARIMIN PRIVAT
PRISTINE, KOSOVË

tentuar që të mos dorëzoj urdhrin mbi shitjen duke lejuar të kalon afati tre (3) vjeçar. Pala ankuese thekson se përmbaruesi privat z. [] ka dhënë urdhër me shkrim për lejimin e përmbarimit pa njoftuar palën debitore dhe po ashtu gjatë gjithë kohës është sjellë në mënyrë jo të dinjitetshme dhe me arrogancë duke mos lejuar pjesëmarrjen e palës ankuese dhe vëllait të tij në seancën e vitit 2017 lidhur me shitjen e paluajtshmërisë objekt i përmbarimit. Pala ankuese, më tutje, pretendon që përmbaruesi privat z. [] ka zhvilluar procedurën përmbarimore në këtë rast në bazë të dokumenteve të pavlefshme. Si rezultat, pala ankuese pretendon se është zbatuar në mënyrë të gabueshme e drejta materiale sepse lidhur me paluajtshmërinë objekt i përmbarimit është duke u zhvilluar procedura e trashëgimisë pranë gjykatës kompetente. Rrjedhimisht, pala ankuese thekson që përmbaruesi privat z. [] ka bërë një varg shkeljesh disiplinore të nenit 367 par 1.1,1.2,1.4 dhe 1.5 të LPP-së, si dhe dispozitave të Kodit të Etikës së Përmbaruesve Privat.

Me datën 23.11.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, pas shqyrtimit të çështjes ka paraqitur në Komisionin Disiplinor Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat z. [] si organ përmbarues, i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në [] lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën P. nr 467/2014.

Përmbaruesi privat z. [] në përgjigjen e tij me shkrim për Komisionin Disiplinor thekson se me dt 06.04.2011, Propozimi për përmbarim nga kreditori fillimisht është iniciuar në Gjykatën Themelore në [] ndaj palës debitore, përkatësisht, Shoqërisë Tregtare " [] " me pronar dhe përfaqësues z. [] në cilësi të kredi- marrësit dhe garantuesit hipotekar dhe garantuesit të dytë z. [] Rrjedhimisht, përmbaruesi privat z. [] thekson që parashtuesi i ankesës z. [] nuk është fare palë në procedurën përmbarimore P. nr. 467/14. Për sa i përket dërgimit të shkresave, përmbaruesi privat z. [] thekson që komunikimet shkresore nga ana e organit përmbarimor me palët debitore z. [] dhe z. [] janë bërë përmes shërbimit postar "Postës së Kosovës", siç e praktikojnë Institucionet Gjyqësore në Republikën e Kosovës. Ndërsa lidhur me pjesëmarrjen në ankandin e shitjes, përmbaruesi privat z. [] thekson se kjo nuk i është mohuar askujt dhe kjo vërtetohet mbi bazën e procesverbalit të seancës së ankandëve ku pjesëmarrës ishte edhe kredi-marrësi/garantuesi z. []

Me datën 27.01.2022, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore publike në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, përmbaruesi privat, z. [] dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese Av. [] Seanca dëgjimore është ndërprerë me kërkesë të përfaqësuesit të autorizuar të palës ankuese, i cili ka kërkuar përjashtimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor. Kërkesa për përjashtimin e anëtarit, është përcjellë, po atë ditë, Ministrisë së Drejtësisë dhe e njëjta është refuzuar si e pabazuar me datën 07.02.2022.

Me datën 08.02.2022, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore publike në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, përmbaruesi privat, z. []

pala ankuese z. _____ nga _____, si dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese Av. _____

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, ka bërë shtjellimin e Raportit Përfundimtar duke theksuar se mbetet pranë të njëjtit. Po ashtu, përmbarruesi privat dhe pala ankuese, kanë ngelur pranë ankesës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitura me shkrim dhe kanë bërë elaborimin e tyre.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se ankesa ndaj përmbarruesi privat z. _____ është e pasafatshme.

Komisioni Disiplinor gjen me rëndësi të thekson që neni 375 i LPP-së, shprehimisht përcakton që *“procedura disiplinore (ndaj përmbarruesit privat theksimi i shtuar) mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vit nga dita e shkeljes.”* Kjo do të thotë se procedura disiplinore më së voni mund të fillohet brenda një (1) viti nga dita e shkeljes së pretenduar disiplinore. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës disiplinore shfaqet më vonë, afati fillon të rrjedh nga ajo kohë. Në rastin në fjalë, parashtruesi pretendon që përmbarruesi privat z. _____ ka bërë një varg shkeljesh disiplinore të nenit 367 par 1.1, 1.2, 1.4 dhe 1.5 të LPP-së, si dhe dispozitave të Kodit të Etikës së Përmbarruesve Privat. Siç u theksuar më lartë, pala ankuese thekson që përmbarruesi privat z. _____ ka lëshuar urdhër me datën 31.05.2018 për shitjen e pronës së tij të trashëguar ligjërisht dhe në të cilën ai dhe familja e tij jetojnë më mirëbesim më tepër se njëzet (20) vite. Gjithashtu pala ankuese thekson z. _____ ka dhënë urdhër me shkrim për lejimin e përmbarrimit pa njoftuar palën debitore dhe po ashtu gjatë gjithë kohës është sjellë në mënyrë jo të dinjitetshme dhe me arrogancë duke mos lejuar pjesëmarrjen e palës ankuese dhe vëllaut të tij në seancën lidhur me shitjen të vitit 2017. Sipas palës ankuese përmbarruesi privat z. _____ ka zbatuar përmbarrimin në bazë të dokumenteve të pavlefshme me ç’rast pretendohet se është zbatuar në mënyrë të gabueshme e drejta materiale. Po ashtu, pala ankuese thekson që lidhur me paluajtshmërinë objekt i përmbarrimit është duke u zhvilluar procedura e trashëgimisë pranë gjykatës kompetente dhe është paraqitur kërkesë për masë të përkohshme.

Komisioni Disiplinor gjen se përmbarrimi në rastin konkret është lejuar me Aktvendimin e Ish Gjykatës Komunale, tani Gjykatës Themelore në _____ E. nr 481/11, të datës 12.08.2013. Pastaj rasti ishte deleguar tek përmbarruesi privat z. _____ Pala ankuese kishte ushtruar mjetet juridike në gjitha instancat gjyqësore kundër vendimit mbi transferin e lëndës tek përmbarruesi privat por ato ishin refuzuar/hedhur poshtë nga ana e gjykatave respektive. Rrjedhimisht, përmbarruesi privat z. _____ kishte vazhduar me zbatimin e përmbarrimit ashtu që me datën 27.04.2018 kishte caktuar ankandin e dytë të shitjes, në të cilën pala kreditore ka paraqitur ofertën për blerje për shkak se detyrimi i kredisë nuk ishte përmbushur. Pas paraqitjes së ofertës për blerje, përmbarruesi privat kishte nxjerrë Konkluzionin për caktimin e blerësit dhe urdhrin për shitje të datës 31.05.2018. Rrjedhimisht, shkeljet e pretenduara i referohen dhe veprimeve përmbarrimore të ndërmarra deri me datën 31.05.2018 kur është nxjerrë urdhri për shitje të paluatshmërisë objekt i përmbarrimit, dhe si të tilla, për këto shkelje të pretenduara nga pala


ankuese ka kaluar afati prej një (viti) brenda të cilit mund të fillohet procedura disiplinore pranë Komisionit Disiplinor.

Për sa i përket procedurës trashëgimore dhe asaj lidhur me masat e përkohshme të iniciuara nga pala ankuese, Komisioni Disiplinor është i kufizuar që të jap ndonjë analizë apo koment lidhur me to përderisa procedurat ligjore janë duke u zbatuar pranë gjykatës kompetente dhe për atë kohë sa ato nuk lidhen me veprimet e përmbaruesit privat, subjekt i procedurës disiplinore. Siç është theksuar në vazhdimësi nga ana e Komisionit Disiplinor në një numër rastesh disiplinore, procedurat disiplinore nuk janë instancë tjetër gjyqësore apo zëvendësuese e atyre ku palët ndërgjygjëse mund të ngritin çështje ekskluzivisht ligjore për të cilat kompetente janë gjykatat në procedura të rregullta.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni Disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 55/2021, datë 08.02.2022

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.